



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 32/2011
Prishtinë, më 27.09.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha- Shala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani, Biserka Kostiq, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Munguan: Fikrim Damka dhe Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Kamerolli –MI; Halit Gara dhe Ilmi Ahmeti- ARH dhe Sanije Berisha – OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Brikena Hoxha, konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20.09.2011;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për emërim të një anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – kërkoi që pika e katërt e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, për shkak së anëtarët e Komisionit kanë nevojë që të marrin informata shtesë në lidhje me këtë çështje.

Rendi i ditës u miratua me largimin e pikës së katërt (Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për emërim të një anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale).

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20 .09.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 20.09.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës

Kryetari –Tha se për këtë pikë të rendit të ditës, ia kaloj fjalën deputetes Sala Berisha – Shala, kryesuese e grupit punues.

Sala Berisha – Shala – si kryesuese e grupit punues e Projektligjit për Hekurudhat e Kosovës, i propozoi 62 amendamente, për të cilat hapi debat në Komision.

Lutfi Zharku – Propozoi që amendamenti 2 të riformulohet, amendamenti 8, të hiqen përkufizimet për IFRAKOS dhe TRAINKOS dhe në amendamentet 17, 22, 25 dhe 28 raportimi të jetë në muajin janar, e jo në muajin dhjetor të departamenteve të ARH- së.

Propozimet u përkrahen nga Komisioni.

Hashim Deshishku – Propozoi që të shtohen dy amendamente në nenin 38, si vijon:
Amendamenti 35 - neni 38, nënparagrafi 6.1, numri “3” (i anëtarëve të Bordit) zëvendësohet me 4 (katër). Amendamenti 36 - neni 38, nënparagrafi 6.2, riformulohet si vijon: 6.2. Bordi i ARH-së, përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve, dhe njëri prej tyre zgjidhet kryesues, anëtari i pestë i Bordit është drejtori i përgjithshëm i ARH- së.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 04/L-63 për Hekurudhat e Kosovës.

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit